



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A
DEPARTAMENTI SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SHËRBIM INTERNETI PËR NEVOJAT E SHRUKD SH.A”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

SHËRBIMET E INTERNETIT 72400000-4

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës10;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas Formularit përmbledhës të vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiar 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së së fondit të limit të përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumatat dhe shërbimet e realizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për ofrimin e shërbimit Internet nga AKEP, për të gjitha teknologjitë e kërkuara në specifikimet teknike.
- 2.3.3. Operatori ekonomik të paraqesë Liçencë të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për transmetim të dhënash si dhe lejen e përdorimit të frekuencave të licencuara nga AKEP që do të përdoren sipas specifikimeve teknike.
- 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim të Përgjithshme nga AKEP për secilin nga shërbimet e ofruara, të cilat duhet të jenë të vlefshme.
- 2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar për çdo linjë, sipas tabelës në specifikimet teknike, e cila të përmbajë:
- Teknologjinë e përdorur për lidhjen Primare.
 - Teknologjinë e përdorur për lidhjen Back-up
 - Modelin e pajisjes fundore që do të vendoset në çdo pikë

Në rast se, operatori ekonomik midis të tjerave, për zgjidhjen teknike të këtij shërbimi përdor teknologjinë e një operatori tjetër (Fiber, Satelitore, ADSL, etj), atëherë duhet të paraqesë kontratën e lidhur ndërmjet tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet te disponoj Certifikatat për standardet e mëposhtëme, te leshuara nga organizma te akredituara per kete qellim, në përputhje me objektin e prokurimit të kesaj procedure:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) për menaxhimin e cilësisë.
- ISO 27001:2022 (ose ekuivalente) për menaxhimin e sigurisë së informacionit
- ISO_IEC_20000-1:2018(ose ekuivalente) Per teknologjine e informacionit- Menaxhimi i shërbimit
- EN_ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) Per sistemin e menaxhimit te mjedisit
- ISO 37001:2016 (ose ekuivalente) Sistemi i menaxhimit kunder korrupsionit
- BS PAS 99:2012 (ose ekuivalente) Per Sistemin e Menaxhimit te Integruar

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 77 dhe 79 të LPP, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës

Përmbushja e standartit ISO 2000-1 është thelbësor pasi nëpërmjet këtij certifikimi, Operatori Ekonomik duhet të demostrojë si ofrues shërbimi aftësinë për të planifikuar, implementuar, operuar, monitoruar rishikuar dhe përmirësuar shërbimet e ofruara. Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standarteve ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

Përmbushja e standartit EN_ISO 14001:2015 Specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën

e saj mjedisore. Operatori ekonomik kërkon te menaxhoj përgjegjësitë e saj mjedisore ne nje menyre sistematike qe kontribuon ne shtyllën mjedisore te qëndrueshmërisë.

Përmbushja e standartit ISO 37001:2016 Sistemi i menaxhimit kunder korrupsionit. Specifikon kërkesat dhe jep udhëzimet per krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen, rishikimin dhe përmasimin e nje sistemi te menaxhimit kundër rryshfetit. Sistemi mund te jete i pavarur ose mund te integrohet ne nje sitëm te përgjithshëm menaxhimi

Përmbushja e standartit BS PAS 99:2012: Percakton kërkesat e përbashkëta te sistemit te menaxhimit(MS) dhe synohet te perdoret si kornize per zbatimin e dy ose me shume standarteve te sistemit te menaxhimit (MSS) ne nje menyre te integruar Nëpërmjet ketij çertifikimi, Operatori Ekonomik projektton dhe implementon ,realizon asistenca dhe suport teknik mbi sistemet teknologjike, informatike dhe te komunikimit.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës,

duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës, inxhinier IT, të certifikuar si kordinator për sigurimin teknik në fazën e projektimit dhe zbatimit.

I cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune”

Për specialistin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet:

Çertifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar, shqiptar ose i huaj.

- b. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në teknologjinë Internet via Satellite (në rast se përdoret komunikimi satelitor).
- c. Të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar për instalim rrjeti data dhe/ose fibër
- d. Të paktën 3(tre) inxhinier të pajisur me certifikatë CCNA Routing & Switching

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Certifikatat përkatëse,
2. Kontratat e Punës,
3. Diplomat përkatëse

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhen e 6 mujorit të fundit, nga data e publikimit të procedurës, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listepagesave.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar, kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 40 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve të tjerë është përllogaritur si më poshtë:

- Te pakten 5 shoferë
- Te pakten 5 punonjes pozicion helpdesk
- Te pakten 10 operatorë
- Te pakten 10 punetorë

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të sigurojë të gjithë aparaturat e nevojshme dhe shërbimet teknike për realizimin e lidhjes internet.

Ky kriter vërtetohet me një deklaratë nga operatori ekonomik ku deklaron se mund të sigurojë të gjitha aparaturat e nevojshme si dhe shërbimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.2 Operatori duhet të disponojë strukturë Helpdesk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365,

Per permbushje e ketij kriteri OE duhet te paraqes një vetëdeklarim.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të ofroj suport lokal në të gjitha pikat e shënuara në tabelën e përgjithshme për të garantuar maksimumin e cilësisë dhe gjithashtu përgjigje në kohë për çdo defekt.

Në rast defektesh, kompania është përgjegjëse për mirëmbajtjen në efikasitet të kësaj lidhjeje

Koha maksimale e përgjigjes ndaj defekteve të mundshme, pra koha maksimale gjatë së cilës do të kryhet përcaktimi i problemit dhe do të vendoset afati i përafërt i zgjidhjes së tij është 30 min.

Ofrimi i shërbimit internet dhe atij të transmetimit të të dhënave duhet të kryhen brenda një afati kohor jo më shumë se 7 ditë pas datës së lidhjes kontratës.

Koha maksimale e zgjidhjes së problemit, nuk duhet të jetë më shumë se 180 min.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Gjerësia e bandës së ofruar për zyrat qendrore do të jetë 300 Mbits CIR 100 Mbits Internet I dedikuar simetrik + 4 IP publike statike

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Pozicionet ku duhet shërbim i internetit:

Nr .	Qendra	Adresa	Përshkrimi i shërbimi
1	SHRUKD Zyra qendrore	L.17	300 Mbits CIR 100 Mbits Internet I dedikuar simetrik
2	SHRUKD 1	L.11	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
3	SHRUKD 2	L.12	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
4	SHRUKD 3 ITUND Shenavlash	Shenevlash tregu makinave	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
5	SHRUKD 4	Shijak	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
6	SHRUKD 5	Shijak	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
7	SHRUKD 6	L.4	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
8	SHRUKD 7	Sukth	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
9	SHRUKD 8	Manze	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
10	SHRUKD Pompa Nr.9	Kenete	30Mbits Data e dedikuar simetrik
11	SHRUKD Pompa Nr.6	L.17, drini	30Mbits Data e dedikuar simetrik

12	SHRUKD Pompa Nr.5	L.13, rrota kuqe	30Mbits Data e dedikuar simetrik
13	SHRUKD Pompa Nr.4	L.13, Florida tregu	30Mbits Data e dedikuar simetrik
14	SHRUKD Pompa Nr.2	Plepa, blloku	30Mbits Data e dedikuar simetrik
15	SHRUKD Pompa Nr. 1.1	Gole prane hotel kamelia	30Mbits Data e dedikuar simetrik
16	SHRUKD Pompa Nr. 1.2	Shkemb I Kavajes	30Mbits Data e dedikuar simetrik
17	SHRUKD Pompa Nr. 1.3	Shkemb I Kavajes, afer Majestic	30Mbits Data e dedikuar simetrik
18	SHRUKD Pompa Nr.8	L.13, Teuta	30Mbits Data e dedikuar simetrik
19	SHRUKD Pompa Tropikal	Plepa, kompleksi Tropikal	30Mbits Data e dedikuar simetrik
20	SHRUKD Pompa Xhafzotaj	Xhafzotaj	30Mbits Data e dedikuar simetrik
21	SHRUKD Zyra qendrore	Durres L.17	100 Mbits Internet per Backup
22	Zyre xhafzotaj	Xhafzotaj	30Mbits Data e dedikuar simetrik
23	ITUND Gjiri Lalzit	Gjiri Lalzit(Hamallaj)	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
24	ITUND Kavaje	Kavaj Synej	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
25	SHRUKD Pompa Nr.7 sp7	hysen kertusha ish urt	30Mbits Data e dedikuar simetrik
26	SHRUKD Pompa Nr.8 sp8	vollga tek portside	30Mbits Data e dedikuar simetrik
27	zyrat Qendore Kruje	Kruje,BARABIT	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
28	Zyrat	Kavaj	100Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik

29	UKK arke	Kavaj qender	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
30	zyrat qendrore Rrogozhine	Rrogozhine	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
31	SHRUKD Zyra qendrore	L.17	4 ip publike statike
32	SHRUKD Fush Kruje	Fush Kruje	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
33	SHRUKD GOLEM	GOLEM KAVAJE	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
34	SHRUKD Mali I Robit	Mali I Robit	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
35	Kruje Bashkia	Kruje / Bashkia	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
36	SHRUKD Kavaje(zyre e re)	Kavaje(zyre e re) Rruga: "Peshllak u Kavajes"	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik
37	SHRUKD Durrës(zyre e re)	Durrës(zyre e re) Rruga: "Jahja Ballhysa"	50Mbps CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik

TERMAT E REFERENCES:

Shërbimi i internetit është një element thelbësor për funksionimin dhe zhvillimin e suksesshëm të çdo organizate në ditët e sotme. Për shumicën e organizatave, interneti është më shumë se një mjet i thjeshtë komunikimi; është një burim i burimeve dhe informacionit që mund të ndikojë drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimeve dhe suksesin e tyre.

Këtu janë disa mënyra se si shërbimi i internetit është i rëndësishëm për organizatat:

1. Komunikimi dhe bashkëpunimi: Interneti lejon organizatat të komunikojnë me klientët, partnerët dhe personelin në mënyra të ndryshme. Email-i, chat, video-konferencat dhe platformat e bashkëpunimit online bëjnë që bashkëpunimi të jetë më efikas dhe të lejojë punën në distancë.
2. Informacion dhe burime: Për shumicën e organizatave, aksesimi në internet është burim kyç për të gjetur informacionin, dokumentacionin, dhe burimet e nevojshme për të zhvilluar produktet dhe shërbimet e tyre. Ky akses i lehtë në informacion ndihmon në marrjen e vendimeve të informuara.

3. Marketingu dhe komunikimi me klientët: Interneti është një mjet i rëndësishëm për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të organizatës. Përmes faqeve të internetit, mediave sociale, dhe reklamave online, organizatat arrijnë të kenë një prezencë të dukshme dhe të komunikojnë me klientët aktualë dhe të mundshëm.
4. Automatizimi i proceseve: Interneti lejon organizatat të automatizojnë proceset e tyre, përfshirë dërgimin e mesazheve automatike, menaxhimin e inventarit, dhe monitorimin e performances përdorimin e sistemeve Erp në një hapësirë të madhe gjeografike. Kjo rrit efikasitetin dhe ul kostot.
5. Siguria dhe mbrojtja e të dhënave: Sigurimi i shërbimit të internetit është thelbësor për mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit të rëndësishëm. Organizatat duhet të kenë politika dhe mjete të sigurisë për të parandaluar kërcënimet potenciale online.

Në një epokë ku teknologjia është në zhvillim të vazhdueshëm, shërbimi i internetit është një partner i paçmueshëm për organizatat që dëshirojnë të jenë konkurruesë, të rriten dhe të qëndrojnë të përditësuar me zhvillimet e fundit. Kjo është arsyeja pse rëndësia e shërbimit të internetit është e pashmangshme për çdo organizatë, nga të voglat deri te të mëdhatat, në një botë që është e lidhur online.